

		ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësi:		Nr. Prot.:	160/2020
Unit:	ZK	Prot. No.:	
Jednica:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:		Date:	24.07.2020
No. of pages:	-04-	Datum:	
Br. shtabice:		Prishtine/a	



PËR: z. Avdullah Hoti, Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës;

CC: z. Fitim Krsaniqi, Sekretar i Përgjithshëm i ZKM-së;
z. Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore pranë ZKM-së;

NGA: Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci., Kryetar, Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK);
Prof. Dr. Blerim Kamberi, Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK);
Dr. sc. Arianit Jakupi, Kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK);

Datë: 24 korrik 2020

Në mbështetje të Nenit 27, paragrafit 1 të Rregullores Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Oda e Mjekëve të Kosovës në mbështetje të Nenit 5, paragrafin 1 në lidhje me Nenin 2, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, parashtrojnë këtë:

K Ë R K E S Ë

Për anulimin e Udhëzimit Administrativ 05/2017 për Shkollim Specialistik

Ministria e linjës: Ministria e Shëndetësisë

Për shkak se: Akti nënligjor cënon autorizimet ligjore të bazuara në Ligjin Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Ligjin për Shëndetësinë

A r s y e t i m

Me datë 30 maj 2013 Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, me të cilin ishte krijuar baza ligjore e themelimit të Odave të Profesionistëve Shëndetësor. Ligji në fjalë ka përkufizuar Odat si organizata profesionale të cilat do t'i përfaqësojnë interesat e profesionistëve shëndetësor varësisht nga profili profesional, e po ashtu do të jenë bartëse të kompetencave publike të përkufizuara me dispozita ligjore, që do të jenë edhe prerogativat e natyrës vetorganizuese të komunitetit të profesionistëve shëndetësor.

Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, ka përfshirë bazën ligjore për themelimin e pesë (5) odave të profesionistëve shëndetësor, siç përkufizohet me Nenin 2, paragrafin 2 të ligjit, dhe atë si: Oda e Mjekëve, Oda e Stomatologëve, Oda e Farmacistëve, Oda e Fizioterapeutëve dhe Oda e Infermierëve dhe Profesionistëve të Tjerë Shëndetësor.

Ndonëse, Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor ishte miratuar dhe i njëjti ishte shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 23, datës 4 korrik 2013, ndërkaq sipas dispozitave të Nenit 60 të ligjit në fjalë, ky ligj ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare, respektivisht me 20 korrik 2013, ndërsa Ligji për Shëndetësi, i cili ishte publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 13, e datës 07 maj 2013, kishte hyrë në fuqi me 23 maj 2013, Ministria e Shëndetësisë me datë 15.06.2017, kishte nxjerrë Udhëzimin Administrativ 05/2017 për Shkollim Specialistik, akt ky i cili kontestohet nga parashtruesi.

Parashtruesit e kërkesës për anulim të aktit nënligjor, Oda e Mjekëve të Kosovës, Oda e Stomatologëve të Kosovës dhe Oda e Farmacistëve të Kosovës, konsiderojnë se me nxjerrjen dhe zbatimin e aktit në fjalë, parashtruesit por edhe Odave të tjera për profilet të cilat i përfaqësojnë zbatohet shkollimi specialistik, u janë shkëlur kompetencat ligjore të karakterit publik, që janë të përkufizuara me Nenin 9, paragrafin 1 me nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Nenit 72, paragrafit 5 të Ligjit për Shëndetësinë.

Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, në Nenin 9, paragrafin 1 me nënparagrafin 1.7, ka përkufizuar se në kuadër të kompetencave publike, Odat kanë kompetencë lidhur me “verifikimin e ligjshmërisë të procesit të specializimit, organizon provimin specialistik, organizon dhe mbikëqyr sub-specializimet”. Po ashtu, sipas dispozitave të Ligjit për Shëndetësi, sipas Nenit 72, paragrafit 5, verifikimi i ligjshmërisë së procesit të specializimit dhe organizimi i provimit specialistik bëhet nga oda përkatëse profesionale.

Pra bazuar në dispozitat konkrete ligjore, Oda e Mjekëve të Kosovës, konsideron se Udhëzimi Administrativ 05/2017 për Shkollim Specialistik është në kundërshtim të dispozitave ligjore, në përmbajtje të dispozitave konkrete si në vijim:

Neni 4, paragrafët 1 dhe 2 të UA 05/2017 - janë në kundërshtim me Nenin 9, me nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-150 dhe Nenin 72, paragrafin 5 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, për shkak se pjesë e shkollimit specialistik është verifikimi i ligjshmërisë që në kuptim ligjor është kompetencë mbikëqyrëse, e po ashtu si pjesë e organizimit të shkollimit specialistik është edhe organizimi i provimit specialistik, e që sipas këtyre dy dispozitave kompetenca e tillë i njifet Brodit të Specializimeve, organ ky i themeluar me UA 05/2017.

Neni 5, paragrafi 2 me nënparagrafët 2.1, 2.3, 2.7, 2.13, 2.14 të UA 05/2017 – këto dispozita cenojnë në mënyrë të drejtëpërdrejt autorizimet ligjore që iu janë njohur Odave të profesionistëve shëndetësor që përfshinë verifikimin e ligjshmërisë dhe kompetencën e organizimit të provimit specialistik. Në mënyrë të veçantë, nënparagrafët 2.3 që ka të bëjë me emërimin e Komisionit vlerësues, i cili sipas dispozitave të Nenit 37, organizon provimin specialistik, e që bie në ndesh me Nenin 72, paragrafin 5 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, në bazë të të cilit është nxjerrë ky akt nënligjor. Po ashtu në mënyrë specifike, dispozita nga nënparagrafi 2.13, i cili ka të bëjë me

njohjen e stazhit të kryer jashtë vendit, është në kundërshtim me dispozitat e Nenit 72, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë.

Neni 25 i UA 05/2017 – Duke qenë se kjo dispozitë ka paraparë themelimin e Komisionit të Ankesave nga ana e Ministrit, fare nuk është përmendur përbërja e këtij Komisioni. Ndërkaq për nga natyra juridike, organi i shkallës së dytë, edhe në kuptim të dispozitave të Nenit 124, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka rol të verifikimit të ligjshmërisë së aktit administrativ i cili është goditur me mjetin juridik. Kompetenca e verifikimit të ligjshmërisë me këtë dispozitë i është cënuar parashtruesit të kërkesës si në dimensionin e dispozitave të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, ashtu edhe Ligjit për Shëndetësinë, si ligj organik i sketorit shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Neni 27 dhe 28, paragrafi 1 i UA 05/2017 – Evidentimi dhe vërtetimi i vitit të shkollimit specialistik dhe çregjistrimi i specializantit nuk do të duhej të ishte në kompetencë të Bordit të Specializimeve. Kompetenca të tilla duhet jenë të renduara në kuadër të organizimit të provimit specialistik, që është kompetencë ligjore e Odave të Profesionistëve Shëndetësor dhe jo të Bordit, siç është theksuar në këtë dispozitë.

Neni 34, paragrafi 5 i UA 05/2017 – Siç kemi theksuar edhe më lartë, dispozitat e Nenit 72, paragrafit 3 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, kompetencën e njohjes së stazhit dhe titullit specialistik të fituar jashtë vendit, e bazon në propozimin e odave përkatëse, dhe jo në kompetencë të komiteteve specialistike, siç është përkufizuar me këtë dispozitë.

Neni 37 i UA 05/2017 – Dispozita e tillë e cila rregullon provimin specialistik, është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Nenit 9, nënparagrafit 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-150 dhe Nenit 72, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-125, pasi që dispozitat të tilla ia njohin në kompetencë organizimin e provimit specialistik një organi i cili fare nuk ka kompetencë ligjore, e siç është Komisioni vlerësues.

Neni 38 i UA 05/2017 – Dispozita e tillë e cila përcakton përbërjen e këtij organi, e të cilit i janë mëveshur kompetencat që janë të kundërligjshme, bien në ndesh me me dispozitat e Nenit 9, nënparagrafit 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-150 dhe Nenit 72, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-125.

Neni 42 i UA 05/2017 – Edhe në këtë dispozitë me njohjen e kompetencës për të vendosur për mjetin juridik lidhur me vlerësimin në provim specialistik, është cënuar kompetenca ligjore e verifikimit të ligjshmërisë nga ana e Odave të profesionistëve shëndetësor.

Dispozitat e mësipërme, e që janë trembëdhjetë sosh, janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e Nenit 9, nënparagrafit 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-150 dhe Nenit 72, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-125. Kundërligjshmëria e tillë, krahas që cënon kompetencat publike të Odave të Profesionistëve Shëndetësor, është po ashtu edhe në kundërshtim me qënien ligjore të Komisioneve të përhershme të Odave, që janë kategori ligjore, e të cilat janë paraparë me qëllim të ushtrimit të kompetencave publike. Kështu që me Nenin 35, paragrafin 1 me nënparagrafin 1.3, me të cilin si komision i përhershëm është paraparë Komisioni për edukim specialistik, dispozitat e UA 05/2017, duke ia njohur kompetencat ligjore të padisponueshme në kuptim ligjor, e mëveshë Bordin Qendror të specializimeve me kompetenca që nuk i takojnë ligjërisht.

Ne konsiderojmë se, autoriteti Juaj, si organ kushtetues i zbatimit të ligjshmërisë, nuk do të lejojë një kundërligjshmëri të tillë. Aq më shumë kur kihet parasysh se kompetencat ligjore nuk mund as të pakohen, të mohohen e as t'i njifen një autoriteti që ligji nuk ia ka njohur një atribut të tillë.

Prandaj, bazuar në të thënat e mësipërme, në mbështetje të Nenit 27, paragrafit 1 të Rregullores Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkojmë ANULUMIN e tërësishëm të Udhëzimit Administrativ 05/2017 për Shkollim Specialistik, pasi që dispozitat e tilla që janë në kundërligjshmëri me Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, e bëjnë të pakuptimtë pjesën tjetër të aktit dhe se procesi me shfuqizimin e dispozitave të tilla humbet funksionin themelor procedural.

Duke shpresuar që kërkesa jonë do të trajtohet me prioritet dhe seriozitet të veçuar, duke marr parasysh rëndësinë e procesit të shkollimit specialistik, shprehim pritjet tona se kërkesës sonë do t'i përgjigjeni në kohë sa më të afërt duke vërtetuar pohimet e përfshira në te.

Me respekt,

Prishtinë, 24 korrik 2020

Kryetar i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, M.sc.



Kryetar i OSK-së
Prof. Dr. Blënim Kallaberi



Kryetar i OFK-së
Dr.sc. Ariant Jakupi

